



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 266/5 Prot.

Tiranë më 3.07.2019

URDHËR

Nr. 205, datë 3.07.2019

PËR KONTROLLUESIN "MARJETA MEHMETI (PERSON FIZIK)"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Marjeta Mehmeti (Person Fizik)",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.59 datë 20.02.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datë 01.07.2019 u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Marjeta Mehmeti (Person Fizik)", me objekt:

- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një qytetar, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Inspektimi u iniciua mbi bazën e ankesës së një qytetari, mbi pretendimin se sistemi i video survejimit (CCTV), i kontrolluesit "Marjeta Mehmeti" (Person Fizik), vëzhgon i orientuar në drejtim të ambienteve ku ushtron aktivitetin tregtar ankuesi.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "Marjeta Mehmeti (Person Fizik)", konstaton se:

1. Kontrolluesi ushtron veprimtari tregtar në fushën “bar” dhe “fast food” sezonal, sipas objektit të ushtrimit të aktivitetit, të deklaruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Kontrolluesi, ka një sistem video-survejimi (CCTV), të përbërë nga katër kamera, të vendosura respektivisht:
  - a. Dy kamera të cilat vëzhgojnë në drejtim të ambientit të brendshëm dhe të jashtëm (banakut dhe tavolinave) të objektit në të cilin ushtron aktivitetin;
  - b. Dy kamera të tjera janë vendosur në drejtim të rrugës së kalimit përkrah objektit. Referuar imazheve të regjistruara në sistemin e video-survejimit (CCTV), konstatohet se kamerat kanë fushë-pamje përgjatë rrugës dhe objektit në krahun tjetër të rrugës i cili ushtron aktivitet si “bar-restorant”. Subjektet e të dhënave të cilët janë jashtë objektit/territorit në të cilin ushtron aktivitetin tregtar kontrolluesi, janë “kalimtarë” dhe “klientë” të subjektit tregtar “bar-restorant”.

Zyra e Komisionerit, pasi analizoi provat e administruara në vend gjatë inspektimit, konkludon se kontrolluesi kryen përpunim të dhënash imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejimit (referuar konstatimit të germës “b” të pikës dy të konstatimeve), në kundërshtim me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të ligjit nr. 9887 /2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Instalimi dhe përdorimi i sistemit të video-survejimit duhet të bëhet në atë formë që përpunimi i të dhënave të kryhet në përputhje me të drejtat themelore të njeriut, të drejtën për privatësi dhe të drejtën për jetë private dhe familjare.

Për përpunimin e të dhënave me anë të sistemit të video-survejimit, duhet që lloji, specifikimet e kamerave dhe vendosja e tyre të jenë në përputhje me qëllimin për të cilin do të përdoren. Kamerat nuk duhet të pozicionohen dhe të marrin imazhe nga ambiente të cilat nuk përputhen me qëllimin e mbikëqyrjes.

Kamerat mund dhe duhet të përdoren në mënyrë që të synojnë vetëm identifikimin e qartë të problemeve të sigurisë, duke zvogëluar sa më shumë të jetë e mundur kapjen e imazheve të padobishme. Kjo përjasje jo vetëm që zvogëlon shkeljet e mundshme të privatësisë, por gjithashtu mundëson përdorimin e kamerave CCTV në mënyrë më efektive.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 29, 30 pika 1, germa “b” dhe 32 të ligjit nr. 9887 /2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

#### **URDHËROJ:**

1. Kontrolluesi *Marjeta Mehmeti (Person Fizik)*, të realizojë në mënyrë të menjëhershme ndërprerjen e përpunimit të të dhënave imazhe-video të subjekteve të të dhënave, duke hequr ose duke ndryshuar këndin e vëzhgimit të dy kamerave të cituara në pikën 2/b të

këtij Urdhri, të cilat janë në tejkalim të qëllimit të përpunimit të parashikuar në germën "dh", pika 1, të nenit 6 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

2. Kontrolluesi *Marjeta Mehmeti (Person Fizik)*, të shkatërrojë të dhënat imazhe-video të grumbulluara në sistemin e video-survejitimit (CCTV) nëpërmjet dy kamerave të cituara në pikën 2/b të këtij Urdhri, në kundërshtim me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.
3. Kontrolluesi *Marjeta Mehmeti (Person Fizik)*, gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar, të ketë në vëmendje zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Udhëzimin nr.3/2010 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejitimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".
4. Kontrolluesi *Marjeta Mehmeti (Person Fizik)* të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 5 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përmbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
5. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Urdhrave të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative.

Ky urdhër u shpall sot më, 3.07.2019



**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

*Besnik Dervishi*